



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 60

Tiranë – E martë, 30 prill 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 23/2019 datë 18.4.2019	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 1, datë 20.3.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Misionin e Kombeve të Bashkuara në Sudanin e Jugut (UNMISS)”.....
	4643
Ligj nr. 24/2019 datë 18.4.2019	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për ngritjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës dhe kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar.....
	4643
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 246, datë 24.4.2019	Për hapjen e procedurës së pranimit në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil, për vitin 2019.....
	4647
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 247, datë 24.4.2019	Për disa ndryshime në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar.....
	4650

**LIGJ**
Nr. 23/2019**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 1, DATË
20.3.2019, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PJSËMARRJEN E
PERSONELIT TË FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË MISIIONIN E
KOMBEVE TË BASHKUARA NË
SUDANINE JUGUT (UNMISS)”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 1, datë 20.3.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Misionin e Kombeve të Bashkuara në Sudanin e Jugut (UNMISS)”.

Miratuar në datën 18.4.2019.

**Shpallur me dekretin nr. 11180, datë 25.4.2019,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta.**

LIGJ
Nr. 24/2019**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR
NGRITJEN E PIKAVE TË
PËRBASHKËTA TË KALIMIT KUFITAR
NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË
KOSOVËS DHE KRYERJEN E
VEPRIMTARIVE TË PËRBASHKËTA TË
KONTROLLIT KUFITAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për ngritjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës dhe kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 18.4.2019

**Shpallur me dekretin nr. 11181, datë 25.4.2019
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta.**



MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
PËR NGRITJEN E PIKAVE TË
PËRBASHKËTA TË KALIMIT KUFITAR
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE
KRYERJEN E VEPRIMTARIVE TË
PËRBASHKËTA TË KONTROLLIT
KUFITAR

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, në vijim referuar si Palët,

duke vlerësuar marrëdhëniet miqësore, bashkëpunimin dhe fqinjësinë e mirë ndërmjet dy vendeve;

duke marrë parasysh vullnetin për të forcuar dhe zhvilluar më tej bashkëpunimin dypalësh;

duke marrë në konsideratë synimin për arritjen e objektivave për përmirësimin e infrastrukturës së transportit rajonal dhe evropian;

me qëllimin për të thjeshtëzuar dhe lehtësuar procedurat dhe masat e lidhura me kontrollet kufitare të menaxhimit të qarkullimit ndërkufitar ndërmjet dy vendeve;

kanë rënë dakord për sa më poshtë:

Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Përkufizime

Për qëllime të kësaj marrëveshjeje:

“Pikë e Përbashkët e Kalimit Kufitar” – pika e autorizuar për kalimin e kufirit, ku autoritetet e Palëve ushtrojnë verifikime të përbashkëta kufitare.

2. “Verifikimi kufitar” – kontrolli i kryer në PPKK, në mënyrë që personat, sendet e tyre personale, automjetet dhe mallrat të plotësojnë kushtet për hyrjen dhe daljen në territoret e palëve.

3. Vendi i hyrjes – pala kontraktuese, e cila kryen kontrollin kufitar në hyrje.

4. Vendi i daljes – pala kontraktuese, e cila kryen kontrollin kufitar në dalje.

5. Zona e pikës së përbashkët të kalimit kufitar, këtej e tutje ZPPKK – zona e përcaktuar

sipas legjislacionit të vendit pritës, ku nëpunësit e të dy palëve janë të autorizuar të kryejnë verifikimin kufitar, sipas kompetencave.

6. Nëpunës – janë personat të cilët kryejnë detyrat e tyre si përfaqësues të institucioneve përgjegjëse për kontrollin kufitar, si edhe ata përgjegjës për mbikëqyrjen e shërbimeve të autorizuar nga secila Palë Kontraktuese.

7. Mallrat – mallrat, mjetet e transportit dhe vlerat materiale që u nënshtrohen rregullave doganore.

8. Parimi “një ndalesë një kontroll” – verifikimi kufitar i kryer nga nëpunës të dy vendeve vetëm në një vendndodhje, në të njëjtën kohë, ku kryhen të gjitha procedurat.

9. “Vendi pritës” – pala në territorin e së cilës ngrihet PPKK-ja dhe kryhen verifikimi kufitar nga nëpunësit e palëve.

Neni 2

Qëllimi i Marrëveshjes

1. Brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje, palët angazhohet për thjeshtësimin dhe përsheptimin e verifikimeve kufitare, me qëllim lehtësimin e qarkullimit të shtetasve dhe mallrave.

Neni 3

Vendosja e PPKK-së

Pikat e Përbashkëta të Kalimit Kufitar vendosen, me mirëkuptim, në territorin e njëjës prej Palëve.

Neni 4

Ligji i zbatueshëm

Të gjitha aktet ligjore të palëve kontraktuese në lidhje me kontrollin e kufirit do të zbatohen në ZPPKK. Shkelja e këtyre akteve në territorin e ZPPKK-së do të ketë të njëjtat pasojë ligjore sikur këto shkelje të kishin ndodhur në territorin e secilës palë kontraktuese.

2. Veprimtaritë të kryera në ZPPKK nga nëpunësit e shtetit fqinj, kryhen në përputhje me legjislacionin e këtij shteti dhe do të konsiderohen si të kryera në territorin e këtij shteti.

3. Nëpunësit e secilës palë kontraktuese kanë të drejtën të ndalojnë, të arrestojnë ose të



kufizojnë lirinë e një personi gjatë kontrollit kufitar, por vetëm në përputhje me legjislacionin kombëtar respektiv.

4. Kur merren masa sipas paragrafit 3 të këtij neni, nga nëpunësit e secilës prej palëve kontraktuese, nëpunësi i vendit pritës do të informohet menjëherë dhe do ta mbështesë në rast nevojë.

5. Legjislacioni kombëtar i vendit pritës që ka të bëjnë me të huajt dhe azilin, nuk preket nga kjo marrëveshje.

Neni 5

Kontrollet kufitare në hyrje–dalje

1. Shtetasit, automjetet dhe mallrat, të cilët hyjnë dhe/ose dalin nga territori i Palëve, u nënshtrohen kontrolleve të përbashkëta nga autoritetet përkatëse përgjegjëse vetëm një herë, bazuar në parimin “një ndalesë një kontroll”, në hyrje dhe dalje njëri pas tjetrit, sipas legjislacionit kombëtar të secilës palë dhe në përputhje me këtë marrëveshje, në vendet e caktuara për këtë qëllim.

2. Pas nisjes së procedurës së verifikimit kufitar në dalje, oficerët/nëpunësit e shtetit të daljes nuk janë më të autorizuar të kryejnë veprime të lidhura me kalimin e kufirit. Sidoqoftë, nëse pas nisjes së procedurës së verifikimit kufitar në hyrje ka dyshime për vepra penale ose nëse konstatohet se një person, i cili duhet arrestuar ndodhet në zonë, nëpunësit e shtetit të daljes janë të autorizuar që të përsërisin procedurat e verifikimit kufitar, pasi të kenë njoftuar paraprakisht nëpunësit e shtetit të hyrjes.

3. Me pëlqimin e përbashkët, në rastet e rrethanave të paparashikuara dhe të jashtëzakonshme dhe kur ka një rrezik për sigurinë publike, palët kontraktuese mund të bien dakord që të hiqet parimi i kontrollit me një ndalim dhe të rivendosen kontrollet e veçanta.

4. Personat të cilët refuzohen nga oficerët /punonjësit e shtetit të hyrjes, nuk mund të refuzohen të kthehen në shtetin e daljes/originës.

5. Mallrat, importi i të cilave është ndaluar nga nëpunësit e vendit të hyrjes, do të lejohen të kthehen në vendin e daljes.

6. Të ardhurat e mbledhura nga oficerët e shtetit fqinj në formën e tarifave zyrtare për

qëllime të procedurave të kalimit të kufirit në shtetin territorial, kthehen në vendet e tyre respektive dhe nuk do t'u nënshtrohen rregullave të eksportit. Të hollat dhe letrat me vlerë të sekuestruara nga nëpunësit e secilës nga palët gjatë kryerjes së kontrollit doganor, si dhe mallrat ose mjetet e sekuestruara duhet të trajtohen sipas legjislacionit të palës konstatuese dhe nuk u nënshtrohen rregullave të eksportit.

7. Gjatë zbatimit të masave të përmendura në paragrafët 4–6, nëpunësit e Palëve informojnë dhe ndihmojnë njëra-tjetrën.

Neni 6

Dokumenti i identitetit, uniformat dhe armët

1. Nëpunësit e shtetit fqinj, gjatë orarit të shërbimit, në ZPPKK do të mbajnë kartë identiteti zyrtare të shërbimit, që i jep nëpunësit të drejtën të hyjë në ZPPKK, të punojë në të dhe të kthehet në vendin fqinj. Megjithatë, kjo nuk ndalon autoritetet policore të vendit pritës që të refuzojnë hyrjen në ZPPKK për nëpunës të caktuar të vendit fqinj. Nëse një nëpunësi të vendit fqinj i është refuzuar hyrja në vendin pritës, autoritetet përkatëse do të informojnë pa vonesë autoritetet përkatëse të vendit fqinj mbi refuzimin.

2. Nëpunësit e të dy palëve kontraktuese do të mbajnë uniformën e shërbimit gjatë kohës që ata janë të pranishëm në ZPPKK. Në rastet përjashtimore dhe kur bihet dakord nga autoritetet kompetente, nëpunësit mund të mbajnë veshje civile, me shenjën policia /doganat, të dukshme në anën e parme dhe të prapme të veshjeve, ose duke mbajtur dallueshëm kartat e identitetit.

Palët kontraktuese do të informojnë njëra-tjetrën për ndryshimet që mund të ndodhin sipas këtij paragrafi.

3. Nëpunësit e vendit fqinj do të mbajnë vetëm një armë të shkurtër shërbimi (armë brezi), nëse ata janë të autorizuar në këtë mënyrë nga legjislacioni kombëtar. Përveç kësaj, nëpunësit e policisë mund të mbajnë pranga, shkopinj gome dhe gaz lotsjellës, kur janë në detyrë në ZPPKK.



Neni 7

Përdorimi i forcës

1. Forca, duke përfshirë forcën vdekjeprurëse, mund të përdoret vetëm në rastet e mbrojtjes së nevojshme dhe nevojës ekstreme në bazë të legjislacionit kombëtar.

2. Përdorimi i forcës duhet të jetë në përputhje me rrezikun dhe nuk duhet të tejkalojë kufijtë e nevojës për situatën konkrete.

3. Nëpunësit e palës fqinje kanë të drejtën të përdorin forcën fizike për të izoluar personat që prishin rendin në ZPPKK.

4. Autoritetet e vendit pritës do të njoftohen për këto masa pa vonesë dhe, në rastet kur kërkohet, do të ofrojnë mbështetje.

Neni 8

Mbrojtja e nëpunësve

1. Nëpunësit e të dy palëve kontraktuese gëzojnë të njëjtin nivel mbrojtjeje kur kryejnë detyrat e tyre në ZPPKK.

2. Gjykatat e shtetit fqinj kanë juridiksionin për të vendosur rreth kërkesave për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga punonjësit e këtij shteti, në aspektin e zbatimit të ligjit në ZPPKK. Këto pretendime gjykohen mbi bazën e ligjit të shtetit fqinj në fjalë.

3. Në rast shkelje disiplinore, nëpunësit ju nënshtrohen procedimit disiplinor sipas legjislacionit të secilës palë.

Neni 9

Detyrimet dhe pretendimet

Nëse një nëpunës i shtetit fqinj humb jetën ose plagoset në vendin pritës gjatë kryerjes së shërbimeve nga ana e tij dhe/ose në lidhje me këtë shërbim, ose nëse pëson dëmtime fizike të shkaktuara nga një send/objekt që ai/ajo mban me vete, pretendimet kompensohen në përputhje me ligjin e shtetit fqinj.

Neni 10

Ambientet zyrtare

1. Pala pritëse merr përsipër sigurimin e ambienteve të nevojshme për nëpunësit e Palës fqinje, për ushtrimin e funksioneve zyrtare.

2. Mjediset zyrtare të përdorura për kontrollin kufitar nga të dyja palët kontraktuese do të shënohen me shenja zyrtare dhe simbole shtetërore në përputhje me rregulloret e brendshme.

Neni 11

Mirëmbajtja e ambienteve zyrtare

Shpenzimet për mirëmbajtjen e ambienteve të përbashkëta zyrtare të PPKK do të miratohen nga KPE-ja dhe do të ndahen në mënyrë të barabartë mes palëve.

Neni 12

Pajisjet dhe objektet për përdorim zyrtar

1. Objektet dhe pajisjet që janë për përdorim zyrtar në ZPPKK, nga nëpunësit e vendit fqinj, do të përdoren dhe transportohen pa detyrime doganore. E njëjta gjë do të zbatohet për automjetet zyrtare dhe private të përdorura nga nëpunësit gjatë kryerjes së detyrave të tyre.

2. Pajisjet zyrtare të të dyja palëve kontraktuese, të nevojshme për të kryer detyra në lidhje me verifikimin kufitar, në ZPPKK, mund të instalohen dhe të përdoren nga nëpunësit e tyre respektivë.

3. Qentë e shërbimit të të dy palëve kontraktuese do të konsiderohen si pajisje zyrtare dhe do të përdoren në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni.

4. Për çdo lloj ndryshimi që mund të ndodhë në lidhje me paragrafët 1 dhe 2, palët kontraktuese do ta informojnë njëra-tjetrën menjëherë nëpërmjet nëpunësve të tyre në ZPPKK.

5. Pala pritëse, përveç përjashtimit nga pagesa e detyrimeve, do të lejojë instalimin, zhvendosjen, mirëmbajtjen dhe përdorimin e pajisjeve të telekomunikacionit, që përdoren ekskluzivisht në veprimet e vendndodhjeve zyrtare të përcaktuara për kontrollin e kufirit nga nëpunësit e palës fqinje dhe do të lejojë edhe lidhjen e këtyre pajisjeve me pajisjet përkatëse të palës fqinje. Përdorimi i pajisjeve të tilla do të konsiderohet si trafik i brendshëm i palës fqinje.

6. Letrat, korrespondencat zyrtare, dokumentet dhe mjetet e tjera që përmbajnë të dhëna të përdorura nga nëpunësit e secilës palë kur kryejnë detyrat në ZPPKK, si dhe posta zyrtare dhe pajisjet zyrtare nuk do të



kontrollohen apo sekuestrohen nga nëpunësit e palës tjetër.

Neni 13

Komiteti i Përbashkët i Ekspertëve

1. Palët do të ngrenë Komitetin e Përbashkët të Ekspertëve (në vijim “KPE”), i cili do të jetë përgjegjës për zbatimin e Marrëveshjes.

2. KPE-ja do të përbëhet nga 5 (pesë) përfaqësues të përhershëm nga secila Palë, të cilët përfaqësojnë institucionet përgjegjëse për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje.

3. KPE-ja mbledhet rregullisht çdo gjashtë muaj. KPE-ja mund të mbledhet në çdo kohë në rast kërkesë nga ndonjëra prej Palëve Kontraktuese.

4. KPE-ja përcakton vendndodhjen e saktë të PPKK-së, si edhe parametrat e saj teknikë.

Neni 14

Aktet zbatuese, amendamentet dhe shtojcat

1. Nle përputhje me këtë marrëveshje dhe duke marrë në konsideratë rekomandimet e KPE-së, Palët bien dakord të nënshkruajnë protokollin zbatues të nevojshme ndërmjet institucioneve përkatëse.

2. Protokollin përcaktojnë aspektet e lidhura me funksionimin e PPKK-ve, si edhe vendin dhe mënyrën në të cilën do të kryhen kontrollet e përbashkëta.

Neni 15

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Mosmarrëveshjet e lidhura me interpretimin apo zbatimin e kësaj marrëveshjeje zgjidhen nga KPE-ja/autoritetet kompetente të secilës Palë Kontraktuese.

2. Në rast se brenda afatit tremujor KPE-ja nuk mund të gjejë zgjidhje të pranuar nga të dyja Palët, mosmarrëveshjet do të zgjidhen ndërmjet bisedimeve të ndërsjella nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 16

Klauzola e pezullimit

Për arsye sigurie kombëtare, apo për mbrojtjen e interesit publik, secila prej Palëve mund të

pezullojë përkohësisht zbatimin e marrëveshjes apo të secilës prej dispozitave të saj në kushte të rrethanave që diktojnë një vendim të tillë në territorin e tyre. Pala tjetër kontraktuese njoftohet menjëherë me shkrim.

Neni 17

Dispozitat përfundimtare

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi pas ratifikimit të saj nga Palët, sipas procedurave të tyre kombëtare. Instrumentet e ratifikimit shkëmbehen sa më shpejt që të jetë e mundur.

2. Kjo Marrëveshje nënshkruhet për një periudhë të pacaktuar kohe dhe mund të zgjidhet në çdo kohë, nëpërmjet njoftimit me shkrim përmes kanaleve diplomatike. Marrëveshja pushon së vepruari gjashtë muaj nga marrja e njoftimit nga pala tjetër për zgjidhjen e saj.

3. Kjo marrëveshje nënshkruhet në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, njëlloj të barasvlershme.

Nënshkruar në , më datë . .2018.

**Për Këshillin e Ministrave
të Republikës së Shqipërisë**

**Për Qeverinë e
Republikës së Kosovës**

VENDIM

Nr. 246, datë 24.4.2019

**PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË
PRANIMIT NË KATEGORINË E ULËT
DHE TË MESME DREJTUESE EDHE
PËR KANDIDATË TË TJERË JASHTË
SHËRBIMIT CIVIL, PËR VITIN 2019**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për vitin 2019, procedura e plotësimit të pozicioneve të lira të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese, për të cilat lëvizja paralele është mbyllur pa fitues, të jetë e hapur edhe për



kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendet e lira.

2. Numri maksimal i pozicioneve, për të cilat do të përdoret procedura e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, është:

a) 13 pozicione për kategorinë e mesme drejtuese;

b) 38 pozicione për kategorinë e ulët drejtuese.

3. Pozicionet në të cilat mund të konkurrojnë edhe kandidatë nga jashtë shërbimit civil për nivelin e mesëm drejtues, gjithsej 13, si dhe për nivelin e ulët drejtues, gjithsej 35, përcaktohen në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Lidhja 1

Pozicionet në të cilat mund konkurrojnë edhe kandidatë nga jashtë shërbimit civil

I. Niveli i mesëm drejtues dhe të barazvlefshëm

1. Drejtor i Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Rendit, Sigurisë Publike dhe Çështjeve Vendore, në Ministrinë e Brendshme - kategoria II-b;

2. Drejtor i Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë - kategoria II-b;

3. Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë - kategoria II-b;

4. Drejtor i Drejtorisë së Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe të Çështjeve të Drejtësisë, në Ministrinë e Drejtësisë - kategoria II-b;

5. Drejtor i Drejtorisë së Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit, në

Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Shëndetësinë dhe Mbrojtjen Sociale, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale - kategoria II-b;

6. Drejtor i Drejtorisë së Koncesioneve, Prokurimeve dhe Partneriteteve, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale - kategoria II-b;

7. Drejtor i Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë - kategoria II-b;

8. Koordinator në Njësinë e Transparencës dhe Antikorrupsionit, në Departamentin e Administrimit, Transparencës dhe Antikorrupsionit, në Kryeministri - kategoria II-b;

9. Koordinator në Sektorin (Zyra) e Menaxhimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm, në Kryeministri - kategoria II-b;

10. Drejtor i Drejtorisë së Trajnimit të Vazhdueshëm, në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike - kategoria II-b;

11. Drejtor i Drejtorisë së Huamarrjes, në Drejtorinë e Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, kategoria II-b;

12. Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Programeve dhe Projekteve në Fushën e Zhvillimit Ekonomik dhe Arsimit Profesional, në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit Ekonomik dhe Punësimit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë - kategoria II-b;

13. Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm Territorial i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, kategoria - II-b.

II. Niveli i ulët drejtues dhe të barazvlefshëm

1. Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve dhe Menaxhimit të Aseteve, në Drejtorinë e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Brendshme - kategoria III-a;

2. Përgjegjës i Sektorit të Programimit, Hartimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore, në Drejtorinë e Programimit,



Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Kulturën, në Ministrinë e Kulturës - kategoria III-a;

3. Përgjegjës i Sektorit të Auditimit të Brendshëm, në Ministrinë e Kulturës - kategoria III-a ;

4. Përgjegjës i Sektorit të Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Fushën Penale, në Drejtorinë për Marrëdhëniet Juridiksionale dhe Bashkëpunimin Ndërgjyqësor, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe të Çështjeve të Drejtësisë, në Ministrinë e Drejtësisë - kategoria III-a;

5. Përgjegjës i Sektorit për Drejtësinë Penale për të Miturit, në Drejtorinë Rregullatore për Çështjet e Drejtësisë, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe të Çështjeve të Drejtësisë, në Ministrinë e Drejtësisë - kategoria III-a;

6. Përgjegjës i Sektorit të Hartimit të Akteve, në Drejtorinë e Hartimit të Legjislacionit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit, në Ministrinë e Drejtësisë - kategoria III-a;

7. Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Financës, në Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit - kategoria III-a;

8. Përgjegjës i Sektorit të Financës, në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Mbrojtjes - kategoria III-a;

9. Përgjegjës i Sektorit të Politikës me Jashtë, në Drejtorinë e Politikave NATO dhe BE, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Mbrojtjes, në Ministrinë e Mbrojtjes - kategoria III-a;

10. Përgjegjës i Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit Shëndetësor, në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale - kategoria III-a;

11. Përgjegjës i Sektorit të Buxhetit, në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e

Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale - kategoria III-a;

12. Përgjegjës i Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit Farmaceutik, në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale - kategoria III-a;

13. Përgjegjës i Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Kërkimit Shkencor, në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë - kategoria III-a;

14. Përgjegjës i Sektorit të Përgatitjes dhe Fizibilitetit të Projekteve për Arsimin Parauniversitar, në Drejtorinë e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë - kategoria III-a;

15. Përgjegjës i Sektorit të Këshillimit Ligjor dhe Monitorimit të Impaktit të Akteve Rregullatore, në Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë - kategoria III-a;

16. Përgjegjës i Sektorit të Veterinarisë dhe Mirëqënies së Kafshëve, në Drejtorinë e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe të Përputhshmërisë në Bujqësi, Ushqim dhe Zhvillim Rural, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural - kategoria III-a;

17. Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimit, në Autoritetin Kombëtar të Ushqimit - kategoria III-a;

18. Përgjegjës i Sektorit të Teknologjisë së Informacionit, në Drejtorinë Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural - kategoria III-a/1;

19. Drejtor i Drejtorisë Juridike, Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit, në Inspektoratin Shtetëror të



Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit - kategoria III-a;

20. Përgjegjës i Sektorit të Promocionit, në Drejtorinë e Marketingut dhe Promocionit, në Agjencinë Kombëtare të Turizmit - kategoria III-a/1;

21. Përgjegjës i Sektorit të Administrimit të Lejeve dhe Autorizimeve, në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore – kategoria III-a/1;

22. Drejtor i Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj, kategoria III-a;

23. Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Tiranë, kategoria III-a;

24. Drejtor Rajonal në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Vlorë - kategoria III-a;

25. Drejtor Rajonal në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Gjirokastrë - kategoria III-a;

26. Drejtor Rajonal në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Korçë - kategoria III-a;

27. Përgjegjës i Sektorit të Vlerësimit në Qendër, në Drejtorinë e Vlerësimit në Qendër, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave - kategoria III-a/1;

28. Përgjegjës i Sektorit të Trajnimeve dhe Etikës, në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave - kategoria III-a/1;

29. Përgjegjës i Sektorit të Mbikqyrjes Doganore, Dega Doganore Tiranë- kategoria III-a/1;

30. Përgjegjës i Sektorit të Operacioneve Doganore, Dega Doganore Kukës - kategoria III-a/1;

31. Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit të Sigurisë, Dega Doganore Durrës - kategoria III-a/1;

32. Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Kontratave të Konkensionit, në Drejtorinë e Konkensioneve, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë- kategoria III-a;

33. Përgjegjës i Sektorit të Çështjeve të Tregtisë, në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, në Drejtorinë e Përgjithshme e Zhvillimit Ekonomik dhe Punësimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë- kategoria III-a;

34. Përgjegjës i Sektorit të Privatizimit dhe Monitorimit, në Drejtorinë e Privatizimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë- kategoria III-a;

35. Përgjegjës i Sektorit të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, në Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit, në Drejtorinë e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë- kategoria III-a.

VENDIM

Nr. 247, datë 24.4.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1 dhe 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës “C”, të titulluar “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da’esh) dhe AL-Qaida”, hiqen individët e renditur në shkronjën “a”, sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për persona që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatave ISIL (Da’esh) dhe AL-Qaida”.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

PËRDITËSIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT TË OKB-SË (“LISTA E OKB-së”)

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATAT ISIL (DA’ESH) DHE AL-QAIDA”:

a) Lista e shtuar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da’esh) dhe AL-Qaida”:

DJAMAT HOUMAT DAAWA SALAFIA (DHDS)

FETHI 2: BEN HASSEN 3: BEN SALEM 4: AL-HADDAD

Shënim. Gjenealitetet e tjera për personin, emri i të cilit është renditur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 84 lekë